

ZYRA PËR KËSHILLA JURIDIKE « BEGZATI »

Lista e disave nga pyetjet që më shpeshti trajtohen përmes shërbimeve të ofruara nga zyra¹

QËNDRIMI

I. Të drejtat e të huajve (Leja e qëndrimit – Vizat – Azili)

Lidhur me temën e lejeve të punës në Zvicër mund të lexoni edhe artikullin tonë të publikuar në albinfo.ch: <http://www.albinfo.ch/si-mund-te-fitojne-nje-leje-pune-ne-zvicer-ata-qe-vijne-nga-jashte/>

Kurse për çështjen e bashkimit familjarë mund të konsultoni [artikullin kushtuar kësaj teme në rubrikën tonë të internetit «Dosje tematike»](#)

1. Në raste dileme, si mund t'a kuptojmë se kur na takon fitimi i lejës së qëndrimit C ? Si mund të merret disa herë para kohe leja e tillë e qëndrimit ?
2. Në raste të pengesave të ndryshme, si duhet vepruar deri te arritja e nxjerrjes së lejës së qëndrimit B ?
3. Edhe pse ligji është tejet restriktiv për akordimin e një leje B për shetatsit që vijnë jasht BE, a ekzistojnë prapëseprap mundësi që ajo të fitohet në disa raste, dhe kush dotë ishin kushtet paraprake?
4. Si dhe kur mund të humbet leja e qëndrimit B, kush janë rreziqet kryesore që duhet të mënjanohen, para se të arrijmë në atë situatë?
5. Kush janë të drejtat për bashkim familjar (për fëmijët dhe bashkëshortët)? Edhe pse afati ligjor për bërjen e kërkesës ka skaduar, a ka mundësi prapëseprap të fitohet një e drejtë e tillë dhe kush janë kushtet ?
6. Si mundë të kërkohet dhe fitohet leja e qëndrimit B (sipas bazës humanitare), për peronat që ende i nënshtrohen statusit të azilkërkuessit?
7. Si mund të nxjeret një vizë për vizitë për të afërmit tanë dhe si zhvillohet procedura? Në rast refuzimi, si duhet vepruar ? Cilët dokumente duhet përgaditur ?
8. Si mund të fitohet viza dhe leja e qëndrimit për studime? Çka na pret pas kryerjes së studimeve (diplomimit, etj), a duhet domosdoshmërisht me lëshuar Zvicrën? A ekzistojnë munësi me rregullura statusin e qëndrimit dhe kush janë kushtet?

¹ Është kjo një list tejet e shkurtër e shërbimeve të ofruara, e cila synon vetëm të japë një ide mbi shërbimet e propozuara. Lista e tillë nuk është aspak e plotë dhe ajo do të adaptohet dhe kompletohet kohë pas kohe.

9. Në cilat raste mund të kërkojmë rregullimin e statusit të qëndrimit për prindërit tanë të moshur? Kush janë rregullat dhe kushtet që duhet plotësuar? Në çka duhet me patur kujdes gjatë bërjes së kërkesës?
10. Çfarë të drejtash për kërkimin e azilit ekzistojnë sot për shtetasit e vendeve ballkanike?
11. Çfarë të drejtash për punësim kanë njerëzit që vijnë nga shtetet jashtë bashkësisë evropiane? Megjithatë kufizimet ligjore, a kanë të drejtë me fituar një leje pune dhe kush janë kushtet?

SIGURIMI

II. E drejta e sigurimeve (Sigurimi pensional – Sigurimi invalidor – Shtesat fëmijërore- Sigurimet private të pensionimit)

Lidhur me problematikën e pensionimit të njerëzve tanë nga Kosova që kanë punur në Zvicër, mund të konsultoni edhe artikullin tonë të publikuar në gazetën « Bota Sot » ;
<http://www.botasot.info/opinione/608666/ku-kemi-arritur-sot-me-ceshtjen-e-pensionimit-per-personat-qe-jetojne-ne-kosove/>

Kurse për shtyllat kryesore të pensionimit në Zvicër dhe mundësitë e pensionimit të parakohshëm, [mund të konsultoni edhe dy artikujtë në rubrikën « Dosje tematike »](#)

1. A mundemi të dalim më herët në pension dhe kush janë pasojat financiare ? Konkretisht, për sa zvogëlohen të ardhurat tona nëse dalim më herët në pension ?
2. Si mund të verifikojmë situatën tonë aktuale për me ditur sidomos se çfarë pensioni na pret në të ardhmen ? Sa do të jetë shuma mujore e pensionit tonë ?
3. Nëse pensioni bazë nuk mjafton dhe nuk ekzistojnë aspak burime tjera financiare për me siguruar minimumin jetësor, kush janë të drejtat tona ? Çka parashikon ligji për rastet e tilla ? Ku duhet me u drejtuar ? Si mundet me i bërë llogaritë për me dituar se a na takon ndonjë e ardhur shtesë që dotë plotësonte pensionin normal ?
4. Çka duhet me ditur për njerëzit tanë që kanë punur në Zvicër, kurse tash e presin pensionimin në Kosovë ? Cilat kushte dhe mundësi ofrohen ?
5. Për personin, i cili ka punuar mbrenda disa viteve në Zvicër (për shembull 7-8 vite), e ekzistonë me të vërtetë ndonjë interes me kërkuar vetëm kthimin e kuotizimeve të paguara apo preferohet me prituri moshën ligjore për fitimin e pensionit ? Kush janë dallimet në mes të situatave të ndryshme, n'varësisht nga mosha dhe viti i kuotizimeve ?
6. Çfarë marrëveshje ka Zvicra me Kosovën në fushën e sigurimeve shoqërore ?
7. Kush janë pikat më kryesore për të cilat duhet të kujdesemi gjatë një procedure për fitimin e një rente invalidore ?

SHTETËSIA

III. E drejta e shtetësisë (Format e fitimit dhe humbja e shtetësisë)

Sa iu përket kushteve për fitimin e shtetësisë, të procedurave që aplikohen, por edhe për rastet e humbjes së shtetësisë mund të konsultoni tre artikujtë tonë në rubrikën «Dosje tematike»

1. Si fitohet shtetësia në Zvicër? Kush janë kushtet dhe format e fitimit? Si duhet me reaguari në raste të refuzimit të kërkesës? Kush janë mundësit për me kundërshtuar një vendim negativ ?
2. Gjatë formaliteteve administrative, kush janë pikat kryesore në të cilat duhet të jemi më tepër të kujdesshëm ?
3. Edhe pse i plotësojmë shumicën nga kushtet, por na mungon vetëm plotësimi i një kushti (për shembull, borxhe ndaj shtetit, mosnjohja e mjaftueshme e gjuhës, etj.), vallë a mundet prapëseprap me e mbrojtur kërkesën deri te fitimi i shtetësisë ? Çka dotë kërkohej konkretisht me bërë në rastet e tilla ?
4. Personat që marrohen me shtetas zviceranë e kanë më lehtë me fituar shtetësin, por si dhe çka konkretisht ?
5. Si humbet shtetësia dhe në çka duhet më së tepërmi me patur kujdesë para se të vijmë deri në gjendjen e tillë?
6. Për personat që e kanë fituar shtetësinë përmes procedurës së lehtësuar (p.sh. për arsye martesë me shtetas zviceran), në çka duhet me patur kujdesë nëse vendoset me u shkurorezuar ?
7. Personi që shkurorezohet vetëm pas disa viteve pas fitimit të shtetësisë zvicerane, a rrezikon me humbur pasaportin zviceran ? Kush janë variantat e mundshme që na mbrojnë në rastet e tilla?

BANIMI

IV. E drejta e banimit (Kontrata - Shkëputja e kontratës- Të metat në banesë – Qiraja - Ulja e çmimit të qirasë - Transferimi i kontratës së banimit)

Për mundësitë eventuale të bërjes së një kërkesë për uljen e çmimit të qirasë dhe për kushtet që aplikohen, mund të lexoni artikullin tonë në rubrikën « Dosje tematike »

1. Në çka duhet me patur më së tepërmi kujdesë gjatë lidhjes së një kontrate ?
2. Çfarë vlere ka proçes-verbali që përpilohet në momentin e hyrjes në një banesë ? Sa është afati për me kontestuar diçka që nuk është në rregull dhe nuk është shënuar në proçes-verbal ?
3. Edhe pse e kemi nënshkruar proçes-verbalin në momentin e hyrjes në banesë, a kemi të drejtë të reagojmë më vonë, pas konstatimit të ndonjë problemi ? Si duhet me reaguari (me shkrim, gojarisht, etj) ?

4. Kush dotë ishte mënyra më këshillueshme e veprimit në raste të konstatimit të ndonjë problemi apo të mete në banesë gjatë kohës së banimit ?
5. Pas lidhjes së kontratës, a kemi të drejtë të bazohemi në çmimin e qirasë së personit që banonte para nesh, për me kërkuar uljen e çmimit të qirasë ? Kush janë kushtet dhe afatet që n'a mundësojnë të kërkojmë zvoglimin e qirasë në rastet e tilla ?
6. Në përgjithësi, në cilat raste kemi të drejtë të kërkojmë uljen e çmimit të qirasë (me uljen e përqindjeve të hipotekave, sot të shumtë janë ata që kanë të drejtë) ? E në cilat raste kemi të drejtë të refuzojmë rritjen e çmimit të qirasë të propozuar nga qiradhënësi ?
7. Kush janë kushtet që n'a mundësojnë disa herë që të kemi të drejtë t'a lëshojmë një banesë para kohës së paraparë me ligj apo me kontratë ?
8. A kemi të drejtë të lëshojmë një banesë pasi kemi gjetur një kandidat që e merrë banesën tonë dhe cilat kushte duhet plotësuar në rastet e tilla ? Si duhet vepruar në raste refuzimi të pabazë ?
9. A kemi të drejtë t'a japim banesën tonë në formë të nën-qirasë (për shembull ti jepet dikujt tjetër për një kohë të caktuar) ?
10. Kush mund të n'a përfaqësojë në raste konfliktesh me qiradhënësin ? Pranë cilit autoritet duhet me u drejtuar dhe çka parashikojnë procedurat para tyre ?

PUNA

V. E drejta e punës (Kontrata – Largimi nga puna - Papunësia)

1. Çfarë lloji kontrate të punës kemi dhe cilat të drejta na ofron kontrata e tillë?
2. Kush është orari normal i punës që parashikohet me ligj ? Sa pushim n'a takon ? Kush është rroga minimale e garantuar me ligj ?
3. A kemi të drejtë me kërkuar një çertifikat pune, edhe pse ende punojmë te dikushi ?
4. A kemi të drejtë të ankojemi nëse një çertifikat pune nuk është e përpiluar në mënyrë të drejtë ? Ku duhet me u drejtuar dhe si ?
5. Në rast problemi në punë, ku duhet me u drejtuar ? Çfarë procedurash aplikohen për mbrojtje të ineteresave tona ?
6. Në cilët raste ekziston e drejta për me munguar në punë ?
7. Për personat që kanë fëmijë të vegjël, çfarë kushtesh ofrohen sipas së drejtës së punës ?
8. Gajtë kohës së shtatëzaniës, kush janë të drejtat e grave për me munguar në punë dhe cilat mbrojtje i ofron ligji ?

9. Kur mund të ndodhë shkëputja e një kontrate të punës dhe kush mundë t'a inicojë atë?
10. Çka nënkupton largimi nga puna pa bazë ligjore nga ana e punëdhënësit dhe kush janë mënyrat për me u mbrojtur?
11. Kush janë situatat e mbrojtura me ligj gjatë së cilave një pundhënës nuk ka të drejtë të largojë dikë nga puna ?
12. Çfarë të drejtash n'a ofron sigurimi i papunësisë? Çfarë kushtesh ofrohen nga ana e sigurimit të tillë? Si duhet vepruar në raste të prurjes së ndonjë vendimi i cili zvogëlon numrin e ditëve që na takojnë për me marrë pagesë nga sigurimi përkatës?

FAMILJA

VI. E drejta familjare (Martesa - Ndarja dhe shkurorëzimi - E drejta e vizitës së fëmijëve - Mirëmbajtja e fëmijëve)

1. Në raste martesë, cilat janë dokumentet e nevojshme që kërkohen dhe ku duhet me u drejtuar ?
2. Cilat forma të martesës propozohen sipas ligjit, dhe të cilat ofrojnë kushte të ndryshme?
3. Kush është forma më e përhapur e shkurorëzimit? Cilat janë etapat kryesore dhe çka duhet përgaditur për një procedurë shkurorëzimi ?
4. Ndarja gjatë një kohe të caktuar a ka ndonjë ndikim për vendimin e shkurorëzimit (shpejtimi i procedurës, etj.)?
5. Nëse vendoset për një shkurorëzim me marrëveshje, çfarë formalitetesh dhe procedure n'a pret?
6. Çka parashikon dokumenti « marrëveshje shkurorëzimi » që aplikohet në raste kur të dy bashkëshortët dëshirojnë të shkurorëzohen ?
7. Kush janë shërbimet apo zyrat që kanë të drejtë me përgaditur apo përpiluar dokumentin « marrëveshje shkurorëzimi »? Çka mund të parashikojmë me marrëveshjet e tilla dhe sa jemi të mbrojtur sidomos nëse kemi fëmijë të përbashkët?
8. Në raste të dhunës në familje, çfarë mbrojtje me kërkuar, dhe te cilat organizma duhet me u paraqitur?
9. Kush janë të drejtat dhe obligimet e të dy prindërve pas shkurorëzimit ?
10. Nëse pas vendimit të shkurorëzimit, ndonjëri nga prindët nuk i përmbush obligimet e tija sipas vendimit të gjyqit, çfarë të drejtash ka bashkëshorti tjetër dhe ku duhet me u drejtuar ?
11. Çfarë pasoja ka shkurorëzimi për personat që e kanë fituar lejen e qëndrimit përmes martesës ? Si mundet me u mbrojtur në rastet e tilla ? Kush janë disa nga kushtet më kryesore të cilat mundësojnë me u mbrojtur?

SIGURIMI

VII. Sigurimi shëndetësor (Sigurimi i detyrueshëm – Sigurimi fakultativ)

Lidhur me sigurimet shëndetësore (sidomos për nevojën reale apo jo të ndryshimit të tyre), [mund të konsultoni artikullin tonë në rubrikën « Dosje tematike »](#)

1. Çfarë sigurimesh shëndetësore ofrohen në tregë ?
2. Çfarë thotë ligji federal për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor dhe kush janë dallimet në mes të sigurimeve të ndryshme që duhet të respektojnë ligjin në fjalë ? Çfarë vlere ka një rregull e tillë për ne ?
3. Në realitet, a dallojnë shumë shërbimet në mes të sigurimeve të ndryshme mjekësore, bazuar në ligjin në fjalë ?
4. Kush janë kriterët që mund të n'a japin ndonjë ide më të qartë lidhur me ate se cilin sigurim duhet zgjedhur ?
5. Kush janë variantat më të përhapura që mundësojnë me bërë kursime të konsiderueshme, edhe ate pa mos e humbur aspak cilësinë e shërbimeve të nevojshme ?
6. A ekziston obligimi që çdo sigurim shëndetësor të n'a pranojë apo sigurojë (për shembull, nëse jemi të siguruar diku tjetër dhe veç jemi nën trajtim mjekësor apo të një moshe të shtyerë)?
7. Si mundë t'a vlerësojmë nevojën reale për një sigurim komplementar-shtesë (i cili nuk është aspak i detyrueshëm) ? A ka të drejtë një sigurim që të n'a refuzoj pranimin në sigurimet e tilla ?

STUDIMET

VIII. E drejta për studime (Kushtet - Financimi -Puna)

Për çështjen e së drejtës së punës për të huajtë që i kryejnë studimet në Zvicër mund të konsultoni [artikullin kushtuar kësaj teme në rubrikën tonë të internetit «Dosje tematike»](#)

1. Kush janë kushtet për studime në Zvicër për personat që vijnë nga shtetet jashtë BE (për shembull nga shtetet ballkanike)?
2. Kush janë variantat e mundshme për fitimin eventual të ndonjë burse studimesh?
3. Çfarë të drejtash për punë ofrohen gjatë kohës së studimeve, me lejen e qëndrimit që jepet vetëm për studime?

4. Pas përfundimit të studimeve (diplomimit, etj.), a është e mundshme për një shtetas të vendeve jashtë BE, të rregullojë statusin e qëndrimit në Zvicër dhe kush janë kushtet?

PALUAJTSHMËRITË

IX. E drejta mbi paluajtshmëritë (Kontrata e shitblerjes – Financimi – Hipotekat - Amortizimi)

1. Kush janë kriterët kryesorë objektivë për kuptimin e vlerës së vërtetë të një banese, shtëpie apo ndërtese ? Në çka duhet më së tepërmi me patur kujdesë gjatë një operacioni të blerjes?
2. Kush janë burimet kryesore të financimit ? Çka na ofrojnë arkat e pensionimit për blerjen e një paluajtshmërie dhe kush janë pasojat kryesore të tërheqjes së parave prej arkave të tilla ?
3. Në rast blerje, cilën formë të amortizimit preferohet me e zgjedhur ? Përparsitë dhe të metat e dy formave ekzistuese (direkte dhe indirekte) ? Kush është interesi jonë me lidhur një kontrat në arkat private të pensionimit (si formë e amortizimit indirekt të banesës apo shtëpisë sonë)? Në aspektin tatimor, çfarë përparësish na ofrohen?
4. Cila hipotekë i përshtatet më së tepërmi situatës sonë ? Ku mundë t'i vërejmë më së miri dallimet në mes të një institucioni bankar dhe disa shoqërive të sigurimeve që ofrojnë kredi hipotekore?
5. Në ditën e sotme, cila bankë apo sigurim ofron hipoteka me çmime më të volitshme ?
6. A duhet me iu besuar çdo herë personave-ndërmjetësues të hipotekave apo më së miri do të ishte me iu drejtuar vetë një sigurimi apo banke?

SHOQËRITË TREGTARE (APO TË BIZNESIT)

X. Kushtet – Mundësitë – Financimi

1. Nëse jemi të interesuar për hapjen e një firme (shoqërie tregtare), cila formë do të ishte më e këshillueshme (ndërmarrje individuale, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sàrl-Gmbh), etj), edhe ate n'varsisht nga aktiviteti që dëshirojmë të ushtrojmë?
2. Cilat janë rregullat kryesore të cilat duhet të respektohen për hapjen e shoqërive tregtare?
3. Për cilat aktivitete kërkohet me patur një autorizim apo diplomë specifike?
4. Varisht nga leja e qëndrimit apo shtetësia, cilat aktivitete kemi të drejtë t'i ushtrojmë?
5. Kush janë kontributet e domosdoshme që duhet paguar gjatë ushtrimit të aktivitetit?

6. Kush janë sigurimet e detyrueshme që duhet të bëhen? Kush janë sigurimet tjera, jo të detyrueshme, por që e kanë vlerën e tyre në rast nevoje?
7. Kush janë mundësitë eventuale për fitimin e një përkrahje financiare nga shteti për hapjen e një aktiviteti?
8. Për cilat aspekte kërkohet ndonjë përkujdesje e veçantë që lidhet me mundësitë e pagimit sa më të ulët të tatimeve?

TË DREJTAT E NJERIUT

XI. Barazia dhe mosdiskriminimi (Puna – Banimi- Shkollimi – Sfera të tjera)

1. Në raste diskriminimi në punë (për arsye etnike, fetare etj.), çfarë mbrojtjesh n'a ofrohen dhe çka thotë ligji? Si duhet vepruar?
2. Në raste diskriminimi në banim (për shembull, refuzim i dhënies së një banese për arsye të origjinës), a ekzistojnë mundësi për mbrojtje, çka thotë ligji dhe si duhet vepruar?
3. Cilat akte apo vepra mundë të cilësohen si të karakterit racist? Çfarë mbrojtjesh n'a ofrojnë ligjet zvicerane? Si duhet vepruar në rastë se jemi viktimë apo dëshmitarë të një akti të tillë? Ku mundë të bëhet një padi dhe sa është afati për depozimin e saj? Kush janë fomalitetet?
4. Si duhet vepruar në raste kur dikushi n'a refuzon me n'a shërbyer, vetëm për arsye të origjinës sonë, në një lokal të hapur për publikun e gjërë (p.sh. restoran, kafene, etj.)? E poqese i njëjti akt refuzimi ndodhë diku tjetër (p.sh. refuzimi i hyrjes në një lokal)?
5. Kurse për sferat tjera (shkollim, etj), a ekzistojnë mundësi për mbrojtje në raste dyshimi të diskriminimit dhe kush janë mundësitë më të këshillueshme të veprimit në situatat e tilla?

.....

Neuchâtel, më 28 maj 2017

Zyra për këshilla juridike « BEGZATI »
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel
E-mail : Lirim.Begzati@hotmail.com
Tel. 079/354'67'13
www.zyra-begzati.ch